

10/25/2024

**RREGULLORJA
E PËRGJITSHME PËR
SHPËRNDARJEN E
SHUMAVE QË JU TAKOJNË
BARTËSVE TË TË DREJTAVE
DHE PËRDORIMIN E
SHUMAVE TË
PASHPËRNDARA**

VAPIK 

PRISHTINË

Kuvendi i Anëtarëve të shoqatës “Autoret Vizuel Producentët dhe Interpretuesit e Kosovës”, në mbledhjen e mbajtur me 25.10.2024, në pajtim me nenin 93, paragrafin 4, pikën 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-205 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta si dhe bazuar në nenin 14, paragrafi 1, pika (h) dhe (i) të Statutit, nxjerrë këtë:

RREGULLORJA E PËRGJITHSHE PËR SHPËRNDARJEN E SHUMAVE QË JU TAKOJNË BARTËSVE TË TË DREJTAVE DHE PËRDORIMIN E SHUMAVE TË PASHPËRNDARA

DISPOZITAT HYRËSE

Neni 1

Kjo rregullore përcakton mënyrën e shpërndarjes së honorareve dhe shpërblimeve për përdorimin e veprave audiovizuale të cilat VAPIK i mbledh në bazë të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtave të Përafërta dhe lejes së dhënë për menaxhimin kolektiv të të drejtave nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 2

1. Kjo rregullore do të zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë bartësit e të drejtave që kanë të drejtë në honorare dhe shpërblime të mbledhura sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme të VAPIK-ut, pa dallim në lidhje me kombësinë e tyre, kategorinë e veprës audiovizuale për të cilën ata kanë të drejta dhe pavarësisht nga anëtarësimi në VAPIK.
2. Dispozitat e kësaj rregullore do të zbatohen dhe respektohen në mënyrë konsistente në çdo shpërndarje të honorareve dhe shpërblimeve, duke mos anashkaluar asnjë rregull për të pasuruar ose privuar qëllimisht një bartës të caktuar të së drejtës individuale ose një kategori specifike të titullarëve ose bartësit e së drejtës për një lloj specifik të veprës audiovizuale. Asnjë nga rregullat nuk mund të zbatohet për një qëllim të tillë.

PARIMET E PËRGJITHSHE TË SHPËRNDARJES

Neni 3

1. Këto rregulla marrin parasysh përdorimin aktual të çdo veprë audiovizuale, aty ku është e mundur duke marrë parasysh natyrën e përdorimit dhe nëse është ekonomikisht e justifikueshme bazuar në kostot e mbikëqyrjes dhe monitorimit të përdorimit aktual.

2. Përdorimi aktual i veprave audiovizuale të ritransmetuara përmes kabllos në Republikën e Kosovës, bazuar në të dhënat e shikueshmërisë të marra nga kompanitë që bëjnë matje e shikueshmërisë së programeve televizive. Të dhënat e shikueshmërisë duhet të organizohen sipas përqindjes së shikueshmërisë nga programi televiziv më i shikuar tek ai më pak i shikuar.
3. VAPIK përpunon së paku 3 programe televizive më të shikuara që janë raportuar në bazë të paragrafit të mëparshëm.

BARTËSI FILLESTAR DHE I PREJARDHUR I TË DREJTAVE

Neni 4

1. Bartës fillestar i së drejtës është personi i cili është bashkautor i veprës audiovizuale, interpretues i performancës së përdorur në veprën audiovizuale dhe producenti i filmit të videogramit që përmban veprën audiovizuale sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje. Për qëllime të përfitimit nga kjo rregullore, bartës fillestar i së drejtës do të konsiderohet gjithashtu edhe trashëgimtari ose pasardhësi tjetër universal i bartësit fillestar i cili këtë duhet ta dëshmoj para VAPIK-ut.
2. Bartës i prejardhur i të drejtës është personi i cili ka fituar të drejtën në bazë të prezumimet ligjor të bartjes së drejtave, veprimit juridik ose vendimit të gjykatës.

PREZUMIMI I BARTËSIT TË SË DREJTËS

Neni 5

1. Në pajtim me Ligjin për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, producenti i veprës audiovizuale do të prezumohet si bartës i të gjitha të drejtave të autorit bazuar në nenin 70, paragrafi 4, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me kontratë.
2. Në qoftë se një ose më shumë bartës të drejtave pretendojnë të drejtën për një vepër audiovizuale në të njëjtin rol dhe pjesa e tyre e pretenduar është 100% e të drejtave në veprën audiovizuale atëherë VAPIK do të krijojë një konflikt në bazën e të dhënave dhe do të bllokojë pagesën e shpërblimeve dhe honorarëve për veprën audiovizuale në konflikt derisa të zgjidhet konflikti në mes pretenduesve.
3. Në qoftë se pretenduesit nuk ndërmarrin veprimet ligjore deri në përfundim të afatit të shpërndarjes, me shpërblimet dhe honorarët në fjalë do të veprohet si në nenin 7 të kësaj rregullore.

FONDI I SHPËRNDARJES

Neni 6

1. Për formimin dhe shpërndarjen e fondit të shpërndarjes do të merren parasysh vetëm fondet e mbledhura aktualisht në çdo shpërndarje (dhe jo vlera e faturuar).
2. Fondi i shpërndarjes për çdo vit financiar të shpërndarjes përcaktohet përshtatshëmrisht me zbritjet sipas Rregullores së Përgjithshme për Zbritjet, Rregullore së Përgjithshme të SKA-së dhe të ardhurave të marra nga depozitat bankare.
3. VAPIK do të bëjë bartjen e shumave sipas kësaj rregulloreje bartësve të të drejtave sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më vonë se nëntë (9) muaj nga fundi i vitit financiar në të cilin janë mbledhur të ardhurat nga të drejtat, përveç nëse për arsye objektive që kanë të bëjnë me raportimin nga përdoruesit, identifikimin e të drejtave apo bartësve të të drejtave, mungesën e informacionit mbi veprat dhe çështjet tjera me bartësit e të drejtave, të cilat e pengojnë VAPIK-un në realizimin e shpërndarjes.
4. Kur nuk arrihet të bëhet shpërndarja sipas paragrafi 3 të këtij neni, me shumat në fjalë do të vepohet si në nenin 7 të kësaj rregulloreje.

SHUMAT E PASHPËRNDARA/PËRFITUESIT E PANJOHUR

Neni 7

1. Honoraret dhe shpërblimet e mbledhura për përfituesit që nuk i kanë ofruar VAPIK-ut informacionin e nevojshëm për pagesë sipas legjislacionit në fuqi, ose për të cilët nuk ishte e mundur të sigurohej dokumentacioni i kërkuar për pagesë, ose nuk përfaqësohen nga VAPIK sipas një kontrate ose marrëveshje me një shoqëri apo organizatë tjetër të menaxhimit kolektiv, do të mbahen në një llogari të veçantë nga VAPIK.
2. Në qoftë se VAPIK nuk arrin që të bëjë shpërndarjen brenda afati të përcaktuar në nenin 6, paragrafin 3 të kësaj rregulloreje, VAPIK do të zgjasë afatin edhe për një periudhë shtesë prej 3 muajsh nga skadimi i afatit sipas nenit 6, paragrafit 3 të kësaj rregulloreje, ashtu që do të vërë në dispozicion informacionin sipas paragrafit 4 të këtij neni për:
 - Anëtarët e VAPIK-ut;
 - Organizatat tjera të menaxhimit kolektiv me të cilat ka marrëveshje përfaqësimi, nëse ka;
3. Në qoftë se masa nga paragrafi 2 i këtij neni nuk jep efekt atëherë VAPIK, jo më vonë se 1 vit pas skadimit të afatit shtesë 3 mujor, do të bëjë publik informacionin sipas paragrafit 4 të këtij neni.

4. Informacioni përkatës sipas nenit 2 dhe 3 të këtij neni nënkupton: titullin e veprës audiovizuale, emrin e bartësit të së drejtës, emrin e botuesit ose prodhuesit përkatës të veprës dhe çdo informacion tjetër përkatës, të disponueshëm që mund të ndihmojë në identifikimin e bartësit të së drejtës.
5. Pasi që VAPIK ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme sipas kësaj rregullore dhe ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe pasi të kenë kaluar 3 vite nga fundi i vitit financiar në të cilin ka ndodhur mbledhja atëherë ato shuma do të konsiderohen si të pashpërndara.
6. Pa cenuar të drejtat e bartësve të të drejtave dhe përkitazi me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, Statutin e VAPIK, rregulloret tjera të VAPIK-ut, Këshilli Mbikëqyrës me anë të Vendimeve të tij do të bëjë përdorimin e këtyre shumave të pashpërndara.

PËRCAKTIMI I VLERËS SË PIKËVE PËR SHPËRNDARJE

Neni 8

Vlera e një pike (në euro) për shpërndarje për çdo vit financiar përcaktohet duke pjesëtuar grupin e shpërndarjes me numrin total të pikëve të të gjitha ritransmetimeve individuale të veprave audiovizuale në kanalet televizive të përpunuara në vitin përkatës financiar.

PËRCAKTIMI I VLERËS SË RITRANSMETIMEVE INDIVIDUALE TË VEPRAVE AUDIOVIZUALE

Neni 9

1. Ritranstmetimet individuale të veprave audiovizuale vlerësohen në bazë të tri kriterëve:
 - Lloji ose kategoria e veprës audiovizuale;
 - Kohëzgjatja e veprës audiovizuale;
 - Periudha kohore në të cilën u ritranstmetuar vepra audiovizuale.
2. Numri i pikëve për një ritranstmetim individual të një veprave audiovizuale llogaritet duke shumëzuar pikët sipas kriterëve të përcaktuara në nenet 10, 11, 12 të kësaj rregullore:

| |
|---|
| $\text{Numri i pikëve për ritranstmetimin individual të veprës audiovizuale} =$ $\text{Numri i pikëve nga lloji apo kategoria e veprës audiovizuale} \times \text{Numri i pikëve nga kohëzgjatja e veprës audiovizuale} \times \text{Numri i pikëve nga periudha kohore e veprës audiovizuale}$ |
|---|

3. Vlera e një ritranstmetimi individual të një veprave audiovizuale (në Euro) llogaritet duke shumëzuar numrin e pikëve për ritranstmetimin individual të veprës audiovizuale me vlerën e një pike (në Euro) për shpërndarje. Vlera që rezulton përfaqëson tarifën bruto të së drejtës së autorit të caktuar për ritranstmetimin individual të veprës audiovizuale.

VLERËSIMI I VEPRAVE AUDIOVIZUALE SIPAS LLOJIT OSE KATEGORISË SË VEPRËS AUDIOVIZUALE

Neni 10

1. Ritransmetimi i veprës audiovizuale do të llogaritet duke u bazuar sipas kategorisë ose llojit si në tabelën më poshtë:

| Kategoria | Lloji i Veprës | Pikët |
|-----------|---|-------|
| A1 | FILMAT KINEMATOGRAFIK Filmat që janë shfaqur dhe shpërndarë në Republikën e Kosovës në jo më pak se një projeksion në ditë për shtatë ditë, pavarësisht llojit dhe zhanrit (fiktiv, dokumentar, i animuar etj. | 10 |
| A2 | FILMAT TELEVIZIV Pavarësisht nga lloji, formati dhe zhanri (fiktiv, dokumentar, i animuar, me qëllim të caktuar, duke përfshirë dramën televizive, adaptimet teatrale.) | 7 |
| B1 | VEPRAT AUDIOVIZUALE TELEVIZIVE 1 Seriale dokumentarësh dhe fiktiv, seriale etj. – me deri në 10 episode në sezon dhe me më shumë se 30 episode në total. | 4 |
| B2 | VEPRAT AUDIOVIZUALE TELEVIZIVE 2 Seriale dhe seri me më shumë se 30 e deri në 100 episode për sezon: shfaqje televizive, video koncertesh, video teatrore etj. | 1 |
| B3 | VEPRAT AUDIOVIZUALE TELEVIZIVE 2 Seriale dhe seri me më shumë se 30 e deri në 100 episode për sezon: shfaqje televizive, video koncertesh, video teatrore etj. | 0.5 |
| B4 | VEPRAT AUDIOVIZUALE TELEVIZIVE 3 Seriale dhe seri me më shumë se 100 episoda për sezon etj. | 0.5 |
| C. | VIDEO TË SHKURTËRA MUZIKORE | 0.1 |
| D. | VEPRA TJERA AUDIOVIZUALE Filmat apo intro për revista dhe llojet tjera për TV. | 0.1 |

2. Një vepër audiovizuale e ritransmetuar përmes kabllor që ka pasur premierën televizive në një program të lëshuar nga një transmetues televiziv i regjistruar në Republikën e Kosovës do t'i dyfishohet numri i pikëve.
3. Veprat që për shkak të ekzekutimit të tyre thjesht përfaqësojnë realizimin ose kolazhin e veprave të tjera nuk përfshihen në kategorinë sipas paragrafit 1 të këtij neni (p.sh. programet e lajmeve që informojnë për ngjarjet aktuale në ekonomi, politike, kulturë, sport, tryeza të rrumbullakëta, diskutime, intervista, raporte dhe revista informative, transmetime të drejtpërdrejta ose të vonuara dhe përpunuara në mënyrë editoriale të ngjarjeve dhe ngjarjeve sportive, kulturore, argëtuese dhe fetare.)

VLERËSIMI I VEPRAVE AUDIOVIZUALE SIPAS KOHËZGJATJES**Neni 11**

Çdo sekondë i kohëzgjatjes së ritransmetimit individual të veprës audiovizuale llogaritet si 1 pikë.

VLERËSIMI I VEPRAVE AUDIOVIZUALE SIPAS PERIUdhËS KOHORE TË RITRANSMETIMIT**Neni 12**

Numri i pikëve për periudhën e ritransmetimit të veprës audiovizuale do të llogaritet sipas tabelës më poshtë:

| Kategoria e periudhës | Koha e ritransmetimit | Pikët |
|-----------------------|-----------------------|-------|
| A | 02:00 – 06:59 | 0.5 |
| B | 07:00 – 15:59 | 1 |
| C | 16:00 – 18:59 | 2 |
| D | 19:00 – 22:59 | 10 |
| E | 23:00 – 01:59 | 3 |

VLERËSIMI I BASHKAUTORËVE**Neni 13**

1. Relacioni në mes të bashkautorëve të një veprë audiovizuale individuale, bazuar në totalin e numrit të të gjitha bashkautorëve (si përqindja e secilit bashkautor individual në lidhje me numrin total të pikëve të të gjithë bashkautorëve në atë veprë audiovizuale), do të llogaritet sipas tabelës më poshtë:

| Kategoria | Roli | Perqindja |
|-----------|---|-----------|
| A | Drejtori kryesor | 50% |
| B | Autori i skenarit | 25% |
| C | Autori i dialogut | 5% |
| D | Kompozitori i veprës muzikore për veprën audiovizuale | 10% |
| E | Autorët tjerë të mundshëm | 5% |
| F | Autori i veprës para-ekzistuese | 5% |

2. Në qoftë se ka shumë bashkautorë të të njëjtit lloj për një veprë audiovizuale (p.sh. shumë regjisorë kryesor ose skenarist të shumtë), ata ndajnë përqindjet e caktuara për at lloj bashkautorë në mënyrë të

barabartë (p.sh. secili bashkë-regjisor i veprës audiovizuale i ndahet proporcionalisht shuma nga 50%), përveç në qoftë ndërmjet tyre janë përcaktuar raporte të ndryshme dhe këto raporte janë paraqitur në mënyrë të rregullte në VAPIK.

- Në rastin e një vepre audiovizuale të huaj të sinkronizuar në cilëndo nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, autorit të përshtatjes i caktohet përqindja e plotë e autorit të dialogut, ndërsa regjisorin kryesor i origjinalit të veprës audiovizuale dhe regjisorin kryesor i veprës së sinkronizuar audiovizuale e ndajnë përqindjen që i takon si regjisor kryesor ashtu që regjisorit të veprës origjinale i takojnë 30% ndërsa regjisorit të veprës së sinkronizuar 20%.

LLOGARITJA PËRFUNDIMTARE BRUTO E TARIFËS TË SË DREJTËS SË AUTORIT PËR BASHKAUTORËT

Neni 14

Tarifa bruto e së drejtës së autorit për një bashkautor individual të një vepre audiovizuale (në Euro) llogaritet duke shumëzuar tarifën bruto të së drejtës së autorit të caktuar për ritransmetimin individual të veprës audiovizuale nga neni 9 i kësaj rregullore me pjesën e bashkautorit individual të veprës audiovizuale në lidhje me numrin total të pikëve të të gjithë bashkautorëve të asaj vepre audiovizuale.

Tarifa bruto e të drejtës së autorit për një bashkautor të veprës audiovizuale (në Euro) = Tarifa bruto e të drejtës së autorit për një ritransmetim individual të veprës audiovizuale (në Euro) x Përqindja e një bashkautori individual

INTERPRETUESIT PËRFORMANCA E TË CILËVE PËRDORET NË NJË VEPËR AUDIOVIZUALE

Neni 15

- Nëse interpretuesit nuk dorëzojnë në VAPIK një marrëveshje që përcakton aksionet e shpërndarjes për interpretues që merr pjesë në një vepër audiovizuale, pjesëmarrja e interpretuesve në një vepër audiovizuale do të llogaritet në vartësi të rolit të tyre sipas tabelës si më poshtë:

| Category | Roli | Pikët |
|----------|--|-------|
| A | Udhëheqës - Kryesor | 60% |
| B | Mbështetës | 30% |
| C | Episodik | 7% |
| D | muzikor, valltar dhe/ose përformues muzikor, statist/e, etc. | 3% |

2. Një rol udhëheqës është roli kryesor në një vepër audiovizuale dhe një rol mbështetës është një rol i ndryshëm nga ai i udhëheqës që mbështet rolin kryesor. Një rol episodik është një rol më i vogël në një episod të vetëm të një vepre audiovizuale me shumë episode ose në jo më shumë se dy sekuenca të një vepre audiovizuale.
3. Në rastin e një vepre audiovizuale të sinkronizuar nga një gjuhë e huaj, interpretuesit të versionit në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës ndajnë pikët me interpretuesit e versionit original në proporcion 50:50. Nëse vepra audiovizuale në fjalë është e animuar (pa skena të aktrimit live) atëherë interpretuesit e versionit të sinkronizuar marrin 100% të pikëve të interpretuesit.
4. Për shmangien e dyshimit, interpretuesit performancat e të cilëve janë përdorur në një vepër audiovizuale do të konsiderohen ata interpretues që janë emëruar në mënyrë adekuate në kreditet hapëse dhe/ose mbyllëse të një vepre audiovizuale.
5. Në qoftë se ka shumë interpretues origjinal në të njëjtin rol në një vepër individuale audiovizuale (p.sh. disa role kryesore ose disa role mbështetëse), ata ndajnë në pjesë të barabarta pikët që i takojnë asaj kategorie të interpretuesve (p.sh. dy role kryesore pranojnë secili nga 30% të 60% të pikëve që i takon) përveç nëse mes tyre janë caktuar raporte të tjera dhe këto raporte janë raportuar në mënyrë të rregullte në VAPIK.

LLOGARITJA E SHPËRBLIMIT BRUTO TË INTERPRETUESIT NË BAZË TË LISTËS

Neni 16

Shpërblimi bruto i një interpretuesi origjinal individual në një vepër audiovizuale (në Euro) llogaritet duke shumëzuar shpërblimin bruto të caktuar për një ritransmetim individual të performancës në një vepër audiovizuale nga neni 9 i kësaj rregullore me pjesën e interpretuesit individual origjinal.

Shpërblimi bruto i një interpretuesi origjinal individual në një vepër audiovizuale = shpërblimi bruto i caktuar për një ritransmetim individual të performancës në një vepër audiovizuale x pjesa e interpretuesit individual origjinal

NJOFTIMI PËR TARIFAT E PRANUARA

Neni 17

1. VAPIK do të ndajë dhe do të paguajë tarifën e të drejtave të autorit bazuar në të dhënat që ka ose do të marrë në procesin e trajtimit të tarifave të pashpërndara të së drejtës së autorit, siç specifikohet në Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

2. VAPIK do të njoftojë të gjithë bartësit e të drejtave që ka identifikuar dhe gjetur, ose që kanë dhënë vetë informacionin e tyre të kontaktit, për tarifat e alokuara të së drejtës së autorit që përbëjnë bazën për pagesë.
3. VAPIK identifikon dhe lokalizon bartësit e të drejtave sipas dispozitave të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat tjera të Përafërta, Statutit të VAPIK-ut dhe Rregulloreve të VAPIK, si dhe bazuar në të dhënat që disponon në momentin e ndarjes së tarifës së të drejtës së autorit.

PAGESAT

Neni 18

1. Tarifa bruto e alokuar për të drejtën e autorit u paguhet bartësve të së drejtës nëse VAPIK ka të gjitha të dhënat e nevojshme për të kryer pagesën.
2. Nëse të drejtat e një bashkautorit individual të një veprë audiovizuale ose një interpretuesi në këtë veprë audiovizuale i janë transferuar producentit të filmit në bazë të ligjit (prezumimi i transferimit), një kontrate ose një vendimi të gjykatës, shuma bruto e tarifës të së drejtës së autorit që do t'i përkiste bashkautorit ose interpretuesit individual sipas llogaritjes sipas këtyre Rregullave i paguhet producentit të filmit. Kjo dispozitë vlen edhe për pasardhësit e tjerë ligjorë të bashkautorit të veprës audiovizuale, interpretuesit në veprën audiovizuale ose producentit të filmit.
3. Nëse shumë producentë filmash (producenti kryesor dhe një ose më shumë bashkë producentë) kanë të drejtën për të marrë tarifën bruto të së drejtës së autorit për ritransmetimin e një veprë individuale audiovizuale, tarifa e të drejtës së autorit ndahet dhe paguhet ndërmjet tyre në proporcion të duhur sipas njoftimit që ata i kanë bërë VAPIK-ut.
4. VAPIK do t'i paguajë tarifat e të drejtave të autorit bartësit të së drejtës brenda afateve të përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregullore.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 19

1. Kjo rregullore do të hyjë në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Anëtarëve të VAPIK dhe do të zbatohen për shpërndarjen e tarifave të së drejtës së autorit në vitin 2025.
2. Kjo rregullore do të publikohet në web-faqen e VAPIK brenda 7 ditëve pas miratimit të saj.

Prishtinë, 25.10.2024